



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelaria Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 60/2026
Datë 28/05/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafit 2, nën paragrafi 2.1) të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik si dhe në përputhje me nenin 5 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Sekretari i Përgjithshëm nxjerr këtë:

V E N D I M
për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Znj. Leonora Sylja, nga pozita aktuale Zyrtare Ligjore në Shërbimin Korrektuese të Kosovës, për interes të institucionit transferohet përkohësisht në pozitën: Zyrtare e Lartë Ekzekutive në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pages së pozitës në të cilin është transferuar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Në zbatim të Rregullore ZKM-nr.10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, është paraqitur kërkesa më datë 25/05/2026 për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil, brenda kategorisë së njëjtë profesionale nga pozita Zyrtare Ligjore në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën Zyrtare e Lartë Ekzekutive në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.

Në mbështetje të nenit 63 (paragrafi 1, nën paragrafit 1.1 dhe paragrafit 2, nën paragrafi 2.1) të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe në përputhje me nenin 5 të Rregullores nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar për këtë transferim, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësi civil, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti
Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Leonora Sylaj;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të MD-së.*